



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority



Analiza e tregut të çelikut në Kosovë

për vitet 2020-2023



Autoritet i Konkurrencës

Adresa: Rr. Migjeni nr. 21, 10000 Prishtinë. Kati i VI, zyra Nr.1
Tel: +383 /0/ 38 200 109 82 E-mail: info.konkurrenca@rks-gov.net

Të nderuar,

Bazuar në Ligjin nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës neni 35, neni 39, neni 64, Autoriteti ka autorizuar Departamentin për Mbikëqyrjen e Tregut, të siguroj të dhënat e nevojshme për shqyrtimin paraprak, për konstatimin e gjendjes në tregun relevant (të prodhimit dhe importit) të produktit të çelikut për vitet 2020 - 2023.

Autoriteti i Konkurrencës ka bërë hulumtimin e tregut të çelikut në Republikën e Kosovës, me qëllim të përcaktimit të strukturës dhe pjesëmarrjes të konkurrentëve në treg.

Situata me pandeminë Covid 19 dhe inflacioni ka ndikuar në tregjet nacionale dhe globale, nisur nga çmimet, zingjirin e furnizimit, shkallën e inflacionit, me ç'rast Autoriteti i Konkurrencës për të kuptuar funksionimin e tregjeve të caktuara, ka filluar monitorimin dhe shqyrtimin paraprak, për të kuptuar transparencën, pjesëmarrësit e tregut, dhe shkallën e përqendrimit të tregjeve.

Për të bërë shqyrtimin paraprak në tregun relevant të çelikut, grupi punues ka zhvilluar një sërë takimesh me palët, organet e administratës publike, personat juridik dhe ka bërë hulumtime të ndryshme, për të kuptuar se si funksionon ky treg, dhe për të konstatuar nëse ka interes publik për të filluar procedurën ndaj subjekteve të cilat kanë ndikim të ndjeshëm mbi konkurrencën në tregun përkatës.

Objektivi i monitorimit është mbledhja dhe përpunimi i të dhënave për prodhimin, blerjen, importin dhe eksportin e çelikut (fillimisht prej doganës së Kosovës dhe pastaj përmes pyetësorëve tek operatorët ekonomik), me theks tek perspektiva e strukturës së tregut si dhe për të analizuar tendencat e çmimeve të grurit dhe miellit.

Çeliku është njëri prej metaleve më të përdorura në industrinë e transportit, ndërtimtarisë si dhe energjisë së ripërtishme.

Zhvillimin ekonomik të një vendi e përcakton edhe pjesëmarrja e çelikut në treg, shitja, blerja apo importi për shkak të specifikave që posedon si: pastërtisë, strukturës, qëndrueshmërisë dhe rezistencës. Çeliku është më i pranueshmi sidomos në industrinë e ndërtimtarisë, përkatësisht në ndërtimin e lartë. Pasi që viteve të fundit është shtuar edhe kërkesa për ndërtim të banesave (produkti i fundit) dhe rritja e çmimit në mënyrë zingjirore ka prekur edhe këtë material ndërtimor.

Për nevoja të shqyrtimit paraprak/monitorimit, janë identifikuar dy tregje relevante: tregu i prodhimit dhe i importit.

Studimi i tregut të ndërtimit në Kosovë

Autoriteti ka përzgjedhur të monitorojë/analizojë sektorin e ndërtimit, si një sektor me interes të përgjithshëm me karakter informues për qytetarët.

Shikuar nga perspektiva e konkurrencës, Autoriteti ka për qëllim të monitorojë dhe të analizojë, kushtet dhe mënyrën se si funksionon një treg, në këtë rast tregu i ndërtimit. Autoriteti mund të lëshojë udhëzime për biznese, të ofrojë informacione ose udhëzime për konsumatorët dhe të bëjë rekomandime për qeverinë ose autoritetet tjera publike. Gjithashtu, mund të hapë hetime nëse identifikon prova se Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës mund të jetë shkelur dhe se është e nevojshme të shqiptohen masa parandaluese.

Në tregun e ndërtimit, konkurrenca efektive arrihet nga rivaliteti apo operimi i kompanive që kryejnë punë bazë, për më tepër kryejnë funksione të ndryshme, procedurë e cila karakterizohet më shumë nga marrëdhënia vertikale sesa horizontale.

Ndërsa konkurrenca midis firmave të mëdha dhe të specializuara mund të jetë Oligopolistike. Kur definohen tregjet sipas madhësisë, kompanitë orientohen në bazë të funksionet dhe punës që kryejnë. P.sh vetëm një numër i caktuar i firmave të mëdha mund të përballojnë projekte të mëdha. Ndarja e tregjeve ka për qëllim të parandaloj sjelljet anti-konkurruese ndërmjet firmave të madhësive të ndryshme, pasi që kostot e transportit dhe standardet e sigurisë të vendosura nga rregullatorët, mund të përmbajnë barriera serioze të hyrjes në tregun e ndërtimit.

Një tjetër pengesë që mund të adresohet në procedurat e prokurimit për projektet e ndërtimit, mund të jenë marrëveshjet e fshehta për shkak të kufizimit të qëllimshëm të numrit të ofertueseve, duke vendosur kërkesa më strikte, p.sh që vetëm kompanitë e mëdha mund t'i përballojnë.

Tregu i ndërtimit - mund të ndikohet negativisht nga faktorët e ndryshëm duke përfshirë ;

- sjelljet e kompanive
- struktura e tregut;
- mungesa e informacionit;
- sjellja e konsumatorit;

- ndërhyrja e sektorit publik në treg (me anë të politikave apo rregulloreve)

Meqenëse analiza/monitorimi i këtij tregu ka karakter informativ është e dobishme të mblidhen informata nga burimet të besueshme si;

- Institucionet qeveritare
- rregullatorët dhe organet publike, në nivel kombëtar, rajonal ose lokal
- organizatat ndërkombëtare
- bizneset, duke përfshirë prodhuesit, shpërndarësit/shitësit me shumicë, shitësit me pakicë etj.
- organizatat profesionale, shoqatat sektoriale të biznesit dhe sindikatat
- dhe palët tjera të interesit

Fokusi kryesor i analizës është;

- struktura dhe elementet e industrisë dhe kompanive në Kosovë
- kushtet konkurruese për aktivitetet që lidhen me planifikimin e projektit, punëve të inxhinierisë, duke përfshirë kompani të ndryshme në sektor të ndryshëm të tregut, barrierat për hyrje në treg, fuqia negociuese e furnitorëve/klientëve.

Viteve të fundit vërehet zhvillim i hovshëm i sektorin të ndërtimit në Kosovë, duke përfshirë investimet nga kompanitë e ndryshme të ndërtimit, të cilat po krijojnë ambiente të favorshëm për një konkurrencë efektive, për këtë arsye ky aktivitet përbën një faktor kyç për studimin e këtij tregu.

Tregu Relevant

1.1 Tregu i produktit

Tregu i produktit përcaktohet Çeliku

1.2 Tregu gjeografik

Tregu gjeografik është territori i Republikës së Kosovës

Përmbajtja

1. Situata e përgjithshme, inflacioni, pandemia dhe çmimet (2020-2023)	7
2.Ndikimi i krizave globale në produktin e çelikut	9
2.1 Kosova	11
2.2 Shqipëria	12
2.3 Serbia	14
2.4 Maqedonia	15
2.5 Mali i Zi	18
2.5 Kroacia	19
3.Pasqyra globale e produktit të çelikut/ Bursa Botërore	20
3.1 Bursa Botërore e çelikut:	22
4.Importi, struktura, vendi i origjinës, çmimi	24
4.1 Importi i çelikut në vitin 2020.....	24
4.2 Importi i çelikut në vitin 2021	27
4.3 Importi i çelikut në vitin 2022	30
4.4 Importi i çelikut në vitin 2023	33
5.Shkalla e përqendrimit të tregut të importit tek çeliku	36
5.1 Transparenca e tregut të çelikut	36
5.2 Situata aktuale në ndërmarrjet kosovare	37
6. Konkluzionet për tregun e Çelikut	38
6.1 Rekomandime.....	39

Tabelat, Grafiket dhe Figurat

Figura 1.	10
Figura 2.....	12
Figura 3.....	14
Figura 4.	16
Figura 5.....	17
Figura 6.....	18
Figura 7.....	19
Figura 8.....	27
Figura 9.....	21
Figura 10.....	23
Tabela 1.Importi i çelikut gjatë muajve, 2020	24
Grafiku 1. Levizja e çmimit mesatar, 2020.....	24
Tabela 2. Importi i çelikut sipas shteteve 2020.....	25
Grafiku2 Importi i çelikut sipas shteteve, 2020	25
Tabela 3. Kompanitë importuese, 2020	26
Grafiku 3.Importi i çelikut gjatë muajve, 2020.....	26
Tabela 4. Importi i çelikut gjatë muajve , 2021	27
Grafiku 4. Lëvizja e çmimit mesatar në vitin 2021.....	27
Tabela 5. Importi i çelikut sipas shteteve, 2021	28
Grafiku 5.Importi i çelikut sipas shteteve 2021	28
Tabela 6. Kompanite importuese, 2021	29
Grafiku 6. Kompanitë importuese, 2021.....	29
Tabela 7. Importi i çelikut gjatë muajve, 2022	30
Grafiku 7.Lëvizja e çmimit mesatar në vitin 2022.....	30
Tabela 8. Importi i çelikut sipas shteteve 2022.....	31
Grafiku 8. Importi i çelikut sipas shteteve 2022.....	31
Tabela 9. Kompanitë importuese të çelikut 2022	32
Grafiku 9. Kompanite importuese 2022.....	32
Tabela 10. Importi i çelikut gjatë muajve 2023.....	33
Grafiku 10. Lëvizja e çmimit mesatar në vitin 2023.....	33
Tabela 11 . Importi i çelikut sipas shteteve 2023.....	34
Grafiku 11. Importi i çelikut sipas shteteve 2023	34
Tabela 12. Kompanitë importuese të çelikut 2023	35
Grafiku 12. Kompanitë importuese 2023	35
Figura 11. Nivelet e referencës së përqendrimit - të matura nga Indeksi Herfindahl-Hirschman	36

1. Situata e përgjithshme, inflacioni, pandemia dhe çmimet (2020-2023)

Pandemia Covid-19 rezultoi në një shok të paparashikuar në të gjitha drejtimet, ku edhe në ekonomi pati shtrëngime në kërkesën agregate dhe prodhimin. Konsumi, punësimi dhe çmimet e energjisë u zvogëluan gjatë restriksioneve në vitin 2020 por edhe në një pjesë të vitit 2021, ku natyrshëm edhe niveli i inflacionit pësoi rënie. Në Eurozonë, niveli i ndryshimit të Indeksit të Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHCK) u zvogëlua në 0,3% në muajin Prill 2020 dhe mbeti në 0% deri në fund të vitit 2020.

Në Eurozonë në gusht të vitit 2021 niveli i inflacionit qëndroi në 3%. Problemi kryesor qëndron se oferta nuk mund ta mbërrij kërkesën dhe kjo dërgon në një disekuilibër të tregut. Mirëpo Banka Qendrore Evropiane (BQE) reagoi shpejtë duke lehtësuar masat e politikave monetare. Ndërsa qeveritë e vendeve të Eurozonës implementuan në planin e tyre pako fiskale ku përfshihen: shpenzimet qeveritare, shtyrjet e taksave dhe borxheve, dispozitat e likuiditetit dhe garancionet qeveritare. Në Eurozonë, inflacioni matet me Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHCK) ku përfshihet shporta e të mirave dhe shërbimeve duke reflektuar modele konsumi në familjet evropiane. Përmbajtja e kësaj shporte rishikohet në fillim të çdo viti për të shikuar ndryshimet e konsumit të vitit të mëparshëm.¹

Udhëzimet nga Komisioni Evropian u përfunduan në Dhjetor 2020 me instruksione shtesë nga Eurostat, ku i bënë thirrje institucioneve nacionale statistikore, që të rivlerësonin të mirat dhe shërbimet që u afektuan më së shumti nga kriza, si p.sh: nafta, transporti, restaurantet, hotelet. Kjo për arsye se gjatë pandemisë pati ndryshim të madh në sjelljet e konsumit, si p.sh. restaurantet dhe dyqanet jo esenciale u mbyllën, po ashtu ka pasur ulje të çmimeve të naftës si dhe transporti ajror pësoi rënie. Në përfundim, shporta me të mira dhe shërbime që përdorej për të matur inflacionin nuk mund të matej më me konsumim aktual dhe për këtë arsye duhej të bëhej një ndryshim. Eurostat i përdori këto ndryshime për të kalkuluar IHCK-në, ku ky kalkulim reprezenton modelet e vitit 2020 dhe do të përdoret në vitin 2021 për të matur inflacionin. Për shembull, mesatarja e konsumit të ushqimit dhe alkoolit u rrit për 12% në vitin 2020, mesatarja e transportit u zvogëlua me 11%, ndërsa mesatarja e hoteleve dhe restoranteve u zvogëlua me më shumë se 25%.

¹ Kerstin BERNOTH, Gökhan IDER, 2021. Inflation on the Upswing - Just a Hiccup or a Trend Reversal After All, fq.7 [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/IDAN/2021/695450/IPOL_IDA\(2021\)695450_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/IDAN/2021/695450/IPOL_IDA(2021)695450_EN.pdf)

Përhapja e COVID-19 ka shkaktuar uljen e parashikimeve të konsumit të çelikut dhe uljen e perspektivës së përgjithshme ekonomike. Masat e mbylljes të zbatuara nga qeveritë duke filluar nga marsi 2020 kanë ndikuar rëndë në aktivitetin prodhues dhe sektorët industrialë që përdorin çelik.

Megjithatë, ka disa sfida me të cilat tregu i çelikut ka të ngjarë të përballlet në epokën pas COVID-19. Një nga këto sfida është rritja e kostos së lëndëve të para, si minerali i hekurit dhe qymyri koks, të cilat janë thelbësore për prodhimin e çelikut. Çmimet e këtyre materialeve kanë qenë në rritje, gjë që ka të ngjarë të rrisë koston e prodhimit të çelikut dhe, nga ana tjetër, koston e produkteve të çelikut. Rritja e kostos së energjisë është një sfidë tjetër mes luftës së zhurmshme midis Rusisë dhe Ukrainës.

Për më tepër, industria e çelikut është shumë konkurruese dhe ka shumë lojtarë në treg. Kjo do të thotë që kompanitë do të duhet të fokusohen në inovacionin dhe masat për uljen e kostove për të mbetur konkurruese.

Si përfundim, tregu i çelikut pritet të rikthehet dhe të rritet në mënyrë të qëndrueshme ndërsa bota rimëkëmbet nga pandemia COVID-19. Kërkesa në rritje për projekte infrastrukturore dhe ndërtime të qëndrueshme pritet të nxisin rritjen e tregut. Megjithatë, rritja e lëndëve të para, koston e energjisë dhe konkurrenca në rritje ka të ngjarë të paraqesin sfida për industrinë. Kompanitë do të duhet të fokusohen në inovacionin dhe masat për uljen e kostove për të mbetur konkurruese në treg.

2.Ndikimi i krizave globale në produktin e çelikut


Në vitin 2021, Ballkani Perëndimor pati një shërim të shpejtë nga recesioni Covid-19 ku ekonomitë e gjashtë vendeve e përjetuan këtë situatë. GDP-ja pritet që në fund të vitit 2021 të jetë me 5,9%, ku në vitin 2020 pësoi një rënie me 3,1%. Ky rikthim do të varet nga faktor të ndryshëm, ku përmendim: hapja vendore, faktorët eksternal të eksportit regjional.

Masat e bllokimit ndikuan në furnizimin me metale industriale përmes mbylljeve në rafineri, shkretore dhe miniera, si dhe kufizime në lëvizjen dhe aktivitetin e punëtorëve. Zinku dhe bakri u goditën më keq në Amerikën e Jugut, me një furnizues kryesor, Perunë, që vendosi mbylljet më të gjata të minierave të detyruara nga qeveria, nga marsi deri në fillim të qershorit 2020. Minierat e mineralit të hekurit, nikelit, litiumit dhe kobaltit u prekën relativisht më pak nga ndalimet dhe kufizimet globale.

Rimëkëmbja e çmimeve të metaleve industriale mori vrull në gjysmën e dytë të vitit 2020, duke përfituar nga kërkesa e ringjallur kineze e nxitur nga një nxitje stimuluese e udhëhequr nga infrastruktura që nga tremujori i qershorit të atij viti. Kjo fillimisht rriti kërkesën për mineral hekurit, bakër dhe zink, e ndjekur nga nikel dhe kobalt, ndërsa rikuperimi i shpenzimeve të konsumatorëve u rrit në gjysmën e dytë. Në verën e vitit 2020, ulja e shkallës së infeksionit të valës së parë në Evropë dhe SHBA, së bashku me masat stimuluese, nisën rimëkëmbjen, duke rritur dhe çmimet e metaleve industriale. Ritmi i rimëkëmbjes ekonomike u rrit në tremujorin e dhjetorit në SHBA dhe Evropë, me çmimet e metaleve që përfituan nga një nxitje nga lajmet për miratimet e vaksinave dhe planet e shpërndarjes në muajin e fundit të vitit.

Optimizmi i investitorëve mbi nikelin dhe kobaltin u nxit nga rritja e elektrifikimit të flotës së automjeteve dhe një përshkallëzim i revolucionit të gjelbër, ndërsa shqetësimet e furnizimit mes një mungese të pritshme afatgjatë të pengesave logjistike të nikelit dhe kobaltit në Afrikë mbështetën çmime më të larta.

Figura nr.1



Burimi: <https://www.spglobal.com/market-intelligence/en/news-insights/research/impact-of-covid-19-pandemic-on-industrial-metals-markets-one-year-on>

Rimëkëmbja e çmimeve të metaleve industriale mori vrull në gjysmën e dytë të vitit 2020, duke përfituar nga kërkesa e ringjallur kineze e nxitur nga një nxitje stimuluese e udhëhequr nga infrastruktura që nga tremujori i qershorit të këtij viti. Kjo fillimisht rriti kërkesën për mineral hekur, bakër dhe zink, e ndjekur nga nikeli dhe kobalti, ndërsa rikuperimi i shpenzimeve të konsumatorët u rrit në gjysmën e dytë. Në verën e vitit 2020, ulja e shkallës së infeksionit të valës së parë në Evropë dhe SHBA, së bashku me masat stimuluese, nisën rimëkëmbjen, duke rritur ndjenjën dhe çmimet e metaleve industriale.

2.1 Kosova

Ekonomia e Kosovës është transformuar në ekonomi të tregut, ku ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) përbëjnë shtyllën kryesore të ekonomisë, me rreth 99 % të këtij tregu. Kosova, për të përmirësuar standardin e jetesës si dhe që të ekuilibrojë bilancin negativ tregtar, ka nevojë për një ritëm shumë më të shpejtë të rritjes së eksporteve dhe investimeve në industri. Zhvillimi i sektorëve të industrisë përpunuese është shumë i rëndësishëm për ekonominë e vendit sepse industria përpunuese kontribuon drejtpërsëdrejti në rritjen e vlerës së prodhimit në vend si dhe në rritjen e numrit të punësuarve me profile të ndryshme.

Spektori i prodhimit, bazuar në potencialin që ka, mund të japë kontribut të rëndësishëm në tërë këta tregues por edhe në strukturën e përgjithshme ekonomike të vendit. Megjithatë, sektori i prodhimit po ofron ende mundësi relativisht të kufizuara punësimi, duke punësuar aktualisht rreth 11.09%, të fuqisë punëtore për vitin 2023, ndërsa viti 2022 me 10.62% nga 11% sa ishte në vitin 2021.

Nën sektori i përpunimit të metalit karakterizohet nga një grup i vogël i ndërmarrjeve të mëdha (industri tradicionale të zhvilluara në Kosovë para viteve të 90-ta, shumica e të cilave tashmë janë privatizuar), të cilat përbëjnë pjesën më të madhe të prodhimit, eksporteve dhe punësimit. Ndërmarrjet e këtij nën-sektori, shfrytëzojnë resurset e pasura të Kosovës me xehe të metaleve (p.sh. nikelit), për të prodhuar metale bazë që zakonisht eksportohen, prodhimin e produkteve fundore (tuba të çeliktë, gypa të çeliktë, radiatorë për ngrohje, produkte të galvanizuar të çelikut, etj.).

Në këtë nën sektor, numri më i madh i ndërmarrjeve të regjistruara, janë ndërmarrje të mëdha, dhe të vogla, shumica e të cilave merren me prodhimin e konstrukteve dhe produkteve të metalit që përdoren në industrinë e ndërtimit. Po ashtu, numër të madh të ndërmarrjeve ka prodhimi i komponentëve të metalit, përmes veprimtarisë së përpunimit metalurgjia pluhur, trajtimi dhe veshja e metaleve, si dhe prodhimi i produkteve të metaleve të çmuara, fijeve dhe aluminit.

Figura nr.2

Kodi	Industria Përpunuese	Numri i ndërmarrjeve			Numri i të punësuarve			Qarkullimi		
	Sektori-C	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	1462	1503	1535	9,902	10,931	12,360	472,344,066.98	490,162,510.96	561,085,852.31
11	Prodhimi i pijeve	102	102	94	2,221	2,151	2,327	215,310,255.20	156,508,456.41	196,667,417.27
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	7	5	4	74	56	48	9,410,896.98	4,866,541.49	5,839,657.34
13	Prodhimi i tekstilit	173	179	200	809	938	1,151	21,739,125.04	28,675,745.45	31,186,657.96
14	Prodhimi i veshjeve	350	397	404	1,610	1,841	2,118	18,494,832.71	18,692,419.49	22,958,140.57
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	39	39	39	406	404	365	8,339,665.13	11,597,152.83	10,527,865.53
16	Prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës	521	506	504	2,389	2,655	2,910	78,118,256.02	85,983,088.64	88,625,018.18
17	Prodhimi i letërës dhe produkteve prej letërës	102	111	120	646	628	827	39,551,211.65	43,321,984.42	50,665,776.87
18	Shtypja dhe riprodhimi i mediave të incizuara	180	174	179	962	1,072	1,235	41,332,339.78	31,049,794.57	33,840,325.42
19	Prodhimi i Koksit dhe produkteve të rafinuara të naftës	8	5	6	179	177	186	22,415,373.85	16,482,741.52	15,672,577.76
20	Prodhimi i produkteve kimike	126	123	139	946	1,006	1,127	55,338,301.05	45,075,279.29	51,600,390.37
21	Prodhimi i produkteve bazë farmaceutike dhe preparateve far	6	7	7	118	124	217	-	2,716,465.32	4,661,311.69
22	Prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës	579	626	670	3,661	4,035	4,655	198,116,219.72	257,367,563.53	278,546,416.86
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	545	547	562	5,469	5,458	5,851	324,357,558.04	439,618,261.48	487,503,084.12
24	Prodhimi i Metaleve	128	122	124	794	875	955	79,981,380.12	102,686,591.35	111,455,645.52
25	Prodhimi i produkteve të fabrikuara metalike	770	790	836	3,065	3,292	3,869	160,666,951.86	198,982,656.43	246,434,152.11
26	Prodhimi i kompjuterëve, produkteve elektronike dhe optike	28	27	29	80	97	131	3,681,731.95	-	5,072,127.09
27	Prodhimi i pajisjeve elektrike	44	39	44	261	263	306	19,947,005.06	21,635,183.03	23,538,225.43
28	Prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t.	38	34	38	274	289	324	10,932,204.35	9,029,384.12	8,680,562.01
29	Prodhimi i mjeteve motorike, rimorkio dhe gjysmë rimorkio	6	8	6	111	120	119	4,713,085.63	2,151,554.95	2,345,947.16
30	Prodhimi i mjeteve tjera të transportit	9	4	3	55	50	54	2,081,758.78	2,091,799.46	1,894,727.98
31	Prodhimi i mobileve	549	600	655	4,915	5,684	5,739	190,907,254.90	249,330,671.03	231,832,198.56
32	Prodhimi tjetër p.k.t.	106	110	129	430	549	644	16,536,703.69	21,287,159.64	24,259,084.38
33	Riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve	106	104	117	181	192	250	5,353,314.37	4,042,196.70	4,533,136.45
	Gjithsejtë	5,984	6,162	6,444	39,558	42,887	47,768	2,003,697,898.65	2,243,355,202.11	2,499,426,298.94

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DI/DPI

Bazuar në të dhënat zyrtare sa i përket industrisë së metaleve vërejmë një konstante të vazhdueshme në numrin e ndërmarrjeve që merren me industrinë në fjalë, por mund të konstatojmë edhe një qarkullim në rritje të ndërmarrjeve që është sinjal pozitiv drejt zhvillimit ekonomik të vendit.

2.2 Shqipëria

Në Shqipëri, inflacioni, gjatë vitit 2021 ishte 2.4%, me një rënie të lehtë në krahasim me një vit më parë, kur arriti në 2.5% nivelin më të lartë në katër vjet. Në parashikimet për rritjen ekonomike në 2022, ku norma vjetore llogaritet që të mos kalojë nivelin 4%, një ndikim do të jetë edhe te norma e inflacionit, e cila pritet të bjerë. Por, rritja e çmimeve në shtetet e Europës rrezikon të rrisë të ashtuquajturin inflacion të importuar, pasi importuesit do të blejnë mallrat më shtrenjtë por, nisur nga ndikimi në këtë rritje ekonomike prej zhvillimit masiv të ndërtimit, në kushtet e kësaj norme rritje ekonomike në rënie një pasojë e pritshme negative mund të jetë shpërthimi i një “flluske” të çmimit të aktiveve. Kjo situatë që në gjuhën e makroekonomisë përshkruhet si

stagflacion, në kushtet kur politikat fiskale me ndryshime të shpeshta dhe një ndërhyrje në vendimmarrjen e biznesit diktojnë edhe rrjedhën normale të tregut me një ndikim në ruajtjen e një pozite të disfavourshme për goditje të ardhshme të tregut shqiptar. Kjo është arsyeja pse këtë fillim viti të 2022, përballë inflacionit në nivelin më të lartë të 10 viteve, Banka e Shqipërisë (BSH) vendosi të mos i rrisë normat e interesit. BSH raportoi së fundmi se pesha e inflacionit të importuar në rritjen totale të çmimeve në Shqipëri u rrit ndjeshëm në tremujorin e tretë të vitit. BSH llogarit se kontributi i inflacionit të importuar në inflacionin total rezultoi 54%, kundrejt një mesatareje prej 40% të dy tremujorëve të mëparshëm të vitit. Banka Qendrore parashikon se, në një perspektivë të afërt, presionet e shtuara inflacioniste nga çmimet e huaja parashikohet të jenë të pranishme në inflacionin mesatar në Shqipëri edhe gjatë 2-3 tremujorëve në vijim, për t'u qetësuar gradualisht gjatë vitit të ardhshëm.

Kriza e re në Lindjen e Mesme me kërcënimin e luftës midis Iranit dhe Izraelit po shkakton trazira të reja në tregjet globale të energjisë, metaleve, lëndëve të para dhe mallrave, duke paralajmëruar çmime të larta në treg të kombinuar me pasojat e luftës në Ukrainë. Ndryshimet vjetore të indeksit të kushtimit në ndërtim për banesa.

Figura nr.3



Burimi: <https://www.instat.gov.al/media/13406/indeksi-i-kushtimit-n%C3%AB-nd%C3%ABrtim-p%C3%ABr-banesa-tr-1-2024.pdf>

2.3 Serbia

Norma vjetore e inflacionit e vlerësuar sipas Agjencisë së Statistikave të Serbisë është 7.6%.

Gjatë vitit 2023, prodhimi industrial shprehu rritje prej 2.4%, ndërsa prodhimi – rritje prej 0.5%. Ndërsa, qarkullimi i tregtisë me pakicë shënoi rënie reale prej 1.8%, ndërsa xhiroja e tregtisë me shumicë u ul me 1.0% në terma nominalë. Kur viti 2023 lidhet me vitin 2022, tregtia e jashtme e mallrave e shprehur në euro tregoi rritje të eksporteve me 4,0%, dhe rënie të importeve me 6,0%.

Në bazë mujore krahasimi, indeksi i çmimeve të konsumit (CPI) i Serbisë u rrit me 0.1% në dhjetor 2023, pas rritjes me 0.5% në nëntor.

Rritjet më të mëdha të çmimeve në terma vjetorë në dhjetor 2023 u regjistruan për banesat, uji dhe energjia, me 11,6%, shërbimet e restoranteve dhe hoteleve, me 9.7%, pasuar nga pajisjet shtëpiake dhe mirëmbajtja, me rritje 9.4%. Çmimet e shërbimeve të restoranteve dhe hoteleve u rritën me 10.8% nga viti në vit në dhjetor, shërbimet e kujdesit shëndetësor u rritën me 9.2%, aktivitetet rekreative dhe kulturore u rritën me 9.1%, ndërsa çmimet e veshjeve, këpucëve, alkoolit dhe duhanit u rritën me 8.8%.

Inflacioni ka ndikuar ndjeshëm edhe në aktivitetet e importit dhe eksportit të çelikut të Serbisë në vitet e fundit, veçanërisht nëpërmjet ndikimit të tij në kostot, kërkesën dhe bilancet tregtare.

Vlera e importeve të mallrave në Serbi arriti në 39 miliardë dollarë në vitin 2023. Importet e përgjithshme të mallrave në Serbi u ulën me 3.19% krahasuar me vitin 2022. Importet e mallrave u ulën me 1.31 miliardë dollarë (vlera e importeve të mallrave në Serbi ishte e barabartë me 41 miliardë dollarë në vitin 2022), duke përfshirë çelikon dhe hekurin. Partnerët me të cilët bashkëpunon Serbia në tregtinë e jashtme janë: Kina, Italia, Turqia, Rusia, Hungaria, Polonia, Romania, Franca, Bosnja dhe Hercegovina.

2.4 Maqedonia

Sipas raportit të Bankës Botërore të Maqedonisë së Veriut, norma e inflacionit në vitin 2023 arriti në 9.4%.


Kjo situatë erdhi si pasojë e ndryshimeve vjetore të përqindjes në çmimet e transporti 0.5 %, banesa, uji, rryma, gazi dhe lëndët djegëse të tjera 10.4%, restorantet dhe hotelet 12.7%, mallra dhe shërbime të ndryshme 11.6%.²

Ndërsa, tregtia e jashtme zhvillohet me anë të produkteve si me metalet e çmuara ose komponimet e metaleve të çmuara si substanca aktive, kompletet e instalimeve elektrike të ndezjes dhe kompletet e tjera të instalimeve elektrike të një lloji të përdorur në automjete, avionë ose anije. Partnerët më të rëndësishëm tregtarë të Republikës së Maqedonisë së Veriut janë: Gjermania, Britania e Madhe, Greqia, Serbia dhe Bullgaria.

Në import, produktet më të rëndësishme janë vajrat e naftës dhe vajra të përfituara nga mineralet bituminoze (përveç të papërpunuar), metale të tjera të grupit të platinit dhe lidhjet e tyre, të papërpunuara ose në formë pluhuri, platini dhe lidhjet e platinit, të papërpunuara ose në formë pluhuri dhe energji elektrike.

² <https://seenews.com/news/n-macedonias-annual-inflation-at-9-4-percent-in-2023-1242044>

Figura nr.4



Burimi: Trend Economy


Eksportet e hekurit dhe çelikut ishin 499.45 milionë dollarë amerikanë gjatë vitit 2023, sipas bazës së të dhënave të Kombeve të Bashkuara COMTRADE mbi tregtinë ndërkombëtare.³

Sipas të dhënave paraprake të Entit Shtetëror për Statistika, vlera e përgjithshme e mallrave të eksportuara nga Republika e Maqedonisë së Veriut në periudhën janar-dhjetor 2022 ka qenë 511 444 064 mijë denarë, që është 19.9% rritje në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (2021).⁴

³ <https://tradingeconomics.com/united-states/exports/iron-steel>

⁴ https://www.stat.gov.mk/Default_al.aspx

Figura nr.5



Burimi: Trading Economics- North Macedonia

Sipas të dhënave nga Enti Shtetëror i Statistikave të Maqedonisë, gjatë vitit 2023 janë përfunduar gjithsej 2 331 banesa. Sipërfaqja mesatare e banesave të përfunduara është 128 4 m².

Ndërsa gjatë vitit 2022 janë përfunduar gjithsej 2 457 banesa. Sipërfaqja mesatare e përdorimit të banesave të përfunduara ishte 124.1 m².

Trendi i ndërtimit të banesave individuale, ka shkuar në rënie, sipas të dhënave të Entit Shtetëror të Statistikës, indeksi i volumit të prodhimit industrial në dhjetor 2023, krahasuar me muajin dhjetor 2022, ishte 94.2.

Prodhimi industrial në sektorin Minierat dhe gurorët në dhjetor 2023, krahasuar me dhjetor 2022, është ulur me 3.0%, në seksionin e “përpunimit”, ndërsa në seksionin e “furnizimit” me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar, është ulur me 3.2%.

Rënia në seksionin e përpunimit është kryesisht për shkak të uljes së prodhimit në divizionet si : prodhimi i produkteve ushqimore, prodhimi i materialeve të veshjeve, prodhimi i produkteve bazë farmaceutike dhe preparateve farmaceutike, prodhimi i produkteve të gomës dhe plastikës, prodhimi i produkteve të tjera minerale jo metalike, prodhimi i produkteve metalike të fabrikuar, makineri dhe prodhimi i pajisjeve elektrike.

Prodhimi industrial sipas grupimeve kryesore industriale në dhjetor 2023, krahasuar me dhjetor 2022, ka qenë më i ulët në energji me 23.9%, mallra të ndërmjetme, me përjashtim të energjisë me 9.9%, mallra të konsumit afatgjatë me 1.9% dhe mallra jo të qëndrueshme me 7.4% por, më e lartë tek mallrat kapitale me 22.6%.

2.5 Mali i Zi

Mali i Zi në dhjetor 2021 pati nivelin vjetor të inflacionit me 4.6%. Niveli jo i lëkundur i inflacionit vjen prej kursit të fiksuar të këmbimit. Çmimet e konsumit patën rënie për veshmbathje me – 5.9%, ndërsa një rritje të restoranteve dhe hoteleve me 8.5%. Mirëpo, çmimet e transportit (8.9%) dhe çmimet e ushqimeve (4.8%) pësuan një rritje. Qeveria e Malit të Zi ka vendosur që të ketë kontroll në çmimin e bukës, prej të cilës mund të ketë efekt në disekuilibrin e ofertës dhe kërkesës në treg.⁵

Figura nr.6



Burimi: Agjencioni i statistikave të Malit të Zi- Niveli vjetor i inflacionit në Malin e Zi, Prill 2021/ Janar 2022 (%)

Industria në Mal të Zi ka qenë fuqia e zhvillimit ekonomik të vendit gjatë gjashtëdhjetë viteve të fundit. Metalurgjia (alumini dhe çeliku), energjia dhe transporti sot, janë sektorë kyç. Sektori i përpunimit (metali, druri, ushqimi, letra, përpunimi i tekstilit, etj.), megjithëse në mënyrë sporadike vuan nga recesioni, mbetet ndër shtyllat kryesore të ekonomisë së Malit të Zi.


⁵ Trading Economics, 2021

Sipas *Economy Watch*, gjatë dekadës së fundit industria malazeze ka kapacitet të prodhojë në vit mbi 1 milion ton boksit, 100 000 ton alumin dhe 3 miliardë KWh energji. Rreth 90% e prodhimit të vendit eksportohet, duke ndihmuar Malin e Zi të fitojë më shumë valutë të huaj. Krahas industrisë së metaleve, sektorë të tjerë të rëndësishëm industrialë në vend janë: përpunimi i drurit, tekstil , lëkurë dhe këpucë, pajisje shtëpiake, ndërtim dhe tregti ndërtimi. Industria e përpunimit të metaleve është sektori më i rëndësishëm i prodhimit malazez. Ky sektor përfshin prodhimin e metaleve primare dhe produkteve metalike (metale me ngjyra, çeliku dhe hekuri). “Vetëm sektori i aluminit përfaqëson sektorin më të madh të eksportit për nga vlera brenda Malit të Zi. Tendencat globale brenda industrisë së aluminit sugjerojnë nevojën për të riorientuar fokusin drejt ripërpunimit dhe riciklimit të aluminit, dhe zhvillimit të nën-sektorëve të tjerë të punimit të metaleve, bazuar në aftësitë ekzistuese të fuqisë punëtore brenda sektorit të metaleve dhe kapacitetet kërkimore në shkencën e materialeve, si dhe zgjerimin e produkteve metalike për përdorim në industrinë e ndërtimit”, thekson Ministria e Jashtme e Malit të Zi.

2.6 Kroacia

Sipas të dhënave nga Shoqata e Çelikut – Eurofer, sa i përket prodhimit të Çelikut për vitin 2022 në nivel European, Kroacia qëndron në vendin e 20-të.

Figura nr.7



Burimi: Eurofer

Ndërsa në vitin 2021, Kroacia prodhoi 185,000 tonë metrikë të papërpunuar ende, që paraqet një rritje masive në krahasim me vitin e kaluar. Vëllimi i prodhimit të çelikut të papërpunuar kroat u luhet kryesisht gjatë periudhës së caktuar, me rënie të herëpashershme masive në produktet e çelikut, si në 2012, 2016 dhe 2017, kur u prodhuan 1000 tonë metrikë.⁶

2. Pasqyra globale e produktit të çelikut/ Bursa Botërore

Industria evropiane e çelikut është një lider botëror në inovacion dhe qëndrueshmëri mjedisore. Ajo ka një qarkullim prej rreth 130 miliardë euro dhe punëson drejtpërdrejt rreth 306,000 njerëz me aftësi të larta në BE, duke prodhuar mesatarisht 152 milionë tonë çelik në vit. Më shumë se 500 vende të prodhimit të çelikut në 22 shtete anëtare të BE-së ofrojnë punësim direkt dhe indirekt për miliona më shumë qytetarë evropianë. I integruar ngushtë me industrinë e prodhimit dhe ndërtimit të Evropës, çeliku është shtylla kurrizore për zhvillim, rritje dhe punësim në Evropë. Çeliku është materiali industrial më i gjithanshëm në botë. Mijëra lloje dhe lloje të ndryshme çeliku të zhvilluara nga industria e bën të mundur botën moderne. Çeliku është 100% i riciklueshëm dhe për këtë arsye është një pjesë themelore e ekonomisë rrethore. Si një material bazë inxhinierik, çeliku është gjithashtu një faktor thelbësor në zhvillimin dhe vendosjen e teknologjive inovative, zbutëse të CO₂, duke përmirësuar efikasitetin e burimeve dhe duke nxitur zhvillimin e qëndrueshëm në Evropë. Bashkimi Evropian është prodhuesi i dytë i çelikut në botë pas Kinës, duke prodhuar mesatarisht 170 milionë tonë çelik të papërpunuar në vit. Industria evropiane e çelikut mbetet një lider botëror në segmente të caktuara të produkteve. Sektori evropian i çelikut karakterizohet nga impiante moderne, me efikasitet të energjisë dhe CO₂, që prodhojnë produkte me vlerë të lartë të shtuar ose produkte të veçanta për tregun botëror, bazuar veçanërisht në një rrjet të jashtëzakonshëm kërkimi dhe zhvillimi.⁶

Prodhuesit më të mëdhenjë të çelikut të papërpunuar në Evropë janë: Gjermania, Italia dhe Franca.

⁶ https://www.eurofer.eu/assets/publications/brochures-booklets-and-factsheets/european-steel-in-figures-2023/FINAL_EUROFER_Steel-in-Figures_2023.pdf

Figura nr.8

PRODUCTION

Crude steel production per country: EU

All qualities • in '000,000 metric tonnes


EU COUNTRIES IN DESCENDING ORDER OF CRUDE STEEL PRODUCTION

TABLE • 2022
SOURCE: EUROFER

	2022	% shares 2022
1 GERMANY	36,849	27.0%
2 ITALY	21,599	15.8%
3 FRANCE	12,234	9.0%
4 SPAIN	11,464	8.4%
5 AUSTRIA	7,512	5.5%
6 POLAND	7,407	5.4%
7 BELGIUM	7,030	5.2%
8 NETHERLANDS	6,143	4.5%
9 SWEDEN	4,382	3.2%
10 CZECH REPUBLIC	4,262	3.1%
11 SLOVAKIA	3,872	2.8%
12 FINLAND	3,538	2.6%
13 ROMANIA	2,625	1.9%
14 LUXEMBOURG	1,875	1.4%
15 OTHERS	1,855	1.4%
16 GREECE	1,543	1.1%
17 HUNGARY	857	0.6%
18 SLOVENIA	623	0.5%
19 BULGARIA	482	0.4%
20 CROATIA	169	0.1%
EU 27	136,321	100%

EU COUNTRIES SHOWN BY RELATIVE SIZE OF CRUDE STEEL PRODUCTION

MAP • 2022
SOURCE: EUROFER



European Steel in Figures 2023

www.eurofer.eu

Figura nr.9

PRODUCTION

Crude steel production per country: EU

All qualities •

CRUDE STEEL OUTPUT PER COUNTRY

	2018	2019	2020	2021	2022	% shares 2022
AUSTRIA	6,885	7,424	6,765	7,884	7,512	5.5%
BELGIUM	7,980	7,760	6,119	6,909	7,030	5.2%
BULGARIA	666	566	484	548	482	0.4%
CROATIA	136	69	45	185	169	0.1%
CZECH REPUBLIC	4,938	4,550	4,450	4,788	4,262	3.1%
FINLAND	4,146	3,473	3,498	4,340	3,538	2.6%
FRANCE	15,385	14,451	11,596	13,947	12,234	9%
GERMANY	42,435	39,627	35,679	40,066	36,849	27%
GREECE	1,467	1,350	1,308	1,498	1,543	1.1%
HUNGARY	1,989	1,769	1,513	1,127	857	0.6%
ITALY	24,496	23,190	20,379	24,412	21,599	15.8%
LUXEMBOURG	2,228	2,119	1,886	2,073	1,875	1.4%
NETHERLANDS	6,813	6,657	6,054	6,620	6,143	4.5%
POLAND	10,167	8,956	7,856	8,454	7,407	5.4%
ROMANIA	3,550	3,448	2,790	3,375	2,625	1.9%
SLOVAKIA	4,947	3,931	3,444	4,863	3,872	2.8%
SLOVENIA	692	669	623	701	623	0.5%
SPAIN	14,299	13,503	11,142	14,234	11,464	8.4%
SWEDEN	4,632	4,699	4,383	4,657	4,382	3.2%
OTHERS	2,215	2,033	2,203	1,953	1,855	1.4%
EU 27	160,066	150,244	132,217	152,782	136,321	100%

European Steel in Figures 2023

Komisioni Evropian është i vetëdijshëm për situatën në sektorin e çelikut, i cili vuan jo vetëm nga një problem global i mbi kapacitetit, por edhe nga tregtia e padrejtë, pra nga eksportet e dampuara dhe të subvencionuara. Prandaj, Komisioni po vepron dhe po zbaton plotësisht instrumentet e

mbrojtjes tregtarë (në thelb anti-dumping dhe anti-subvencionim) që disponon për të mbështetur dhe siguruar një fushë loje të barabartë. BE aktualisht ka mbi 100 masa të mbrojtjes tregtare në fuqi, 37 prej tyre synojnë importet e padrejta të produkteve të çelikut, 16 prej të cilave vijnë nga Kina. Më 12 shkurt 2016, Komisioni i BE-së hapi tre hetime të reja anti-dumping për produktet e çelikut me origjinë nga Kina për të përcaktuar nëse ato janë hedhur në tregun e BE-së. Në të njëjtën ditë, Komisioni vendosi detyrime të përkohshme anti-dumping për një produkt tjetër çeliku nga Kina dhe Rusia. Aktualisht po vazhdojnë hetimet për 10 produkte të çelikut, 6 prej të cilave vijnë nga Kina.

3.1 Bursa Botërore e çelikut:

Çeliku(armatura) tregtohet kryesisht në **Shanghai Futures Exchange** dhe **London Metal Exchange**. Kontrata standarde e ardhshme është 10 tonë. Çeliku është një nga materialet më të rëndësishme në botë që përdoret në ndërtim, makina dhe të gjitha llojet e makinerive dhe pajisjeve. Deri tani prodhuesi më i madh i çelikut të papërpunuar është Kina, e ndjekur nga Bashkimi Evropian, Japonia, Shtetet e Bashkuara, India, Rusia dhe Koreja e Jugut. Çmimet e çelikut të shfaqura në *Trading Economics* bazohen në instrumentet financiare pa bursë (OTC) dhe kontratën për diferencën (CFD). Çmimet e çelikut të paraqitura në figurën e mëposhtme kanë për qëllim t'i ofrojnë publikut vetëm një *referencë*, dhe jo si bazë për marrjen e vendimeve tregtare. Fabrikat e çelikut të BE-së dhe furnizuesit e çelikut të vendeve të treta ofrojnë produkte çeliku në tregun e çelikut të BE-së. Tregu i çelikut ka nivele të ndryshme. Produktet e çelikut mund t'u shiten 'indirekt' operatorëve në shpërndarjen e çelikut ose shiten 'direkt' në sektorët që përdorin çelikon.

Figura nr.10



	Price		Day	Month	Year	Date	
Gold	2675.24	▲	14.79	0.56%	2.61%	38.11%	09:07
Silver	31.798	▲	0.333	1.06%	1.31%	37.85%	09:07
Copper	4.3193	▲	0.0188	0.44%	3.50%	21.75%	09:07
Steel	3,420.00	▲	40.00	1.18%	12.61%	-4.71%	Oct/14
Iron Ore	106.44	▲	0.63	0.60%	14.38%	-9.35%	Oct/11

Burimi : <https://tradingeconomics.com/commodity/steel>

Kontratat e së ardhmes të armaturës së çelikut u rritën në 3,420 CNY për ton në tetor, më i larti në gati katër muaj, pasi tregjet vlerësuan premtimet e qeverisë kineze për mbështetje ekonomike ndaj një grupi të dhënash pesimiste. Gjithashtu, të dhënat tregtare treguan se eksportet e çelikut u rritën me 26% nga viti i kaluar në shtator, pasi fabrikat rritën shitjet e huaja për të kompensuar blerjen e dobët nga fabrikat kineze dhe zhvilluesit e pronave.


4.Importi, struktura, vendi i origjinës, çmimi

4.1 Importi i çelikut për vitin 2020

Tabela nr.1 Importi i çelikut gjatë muajve, 2020

Muajt	Sasia	Vlera (EURO)	Çmimi mesatar
1	15,090,060.00	6,602,866.01	0.44
2	10,853,450.00	4,822,058.87	0.44
3	10,352,750.00	4,437,012.64	0.43
4	3,377,260.00	1,469,485.80	0.44
5	16,051,750.00	6,725,516.26	0.42
6	21,396,700.00	8,576,439.30	0.40
7	21,912,230.00	8,880,572.42	0.41
8	18,938,350.00	7,600,361.33	0.40
9	26,477,440.00	10,728,496.58	0.41
10	21,785,102.00	8,820,715.82	0.40
11	20,245,854.00	8,288,655.78	0.41
12	23,523,950.00	10,054,464.18	0.43
Totali:	210,004,896.00	87,006,644.99	0.41

Grafiku nr.1 Lëvizja e çmimit mesatar në vitin 2020




Gjatë vitit 2020, çmimi mesatar i çelikut ishte 0.41 cent, dhe gjatë tërë muajve te këtij viti nuk vërehet ndonjë ndryshim i madh i çmimit. Kërkesa për importin e çelikut ishte mjaftë e lartë nga kompanitë kosovare, përveq në muajin Prill 2020 kur ishte periudha e Covid 19. Në vitin 2020, nuk vërehet ndonjë shqetësim për çmimin e importuar.

Tabela nr.2 Importi i çelikut sipas shteteve, 2020

Shtetet importuese	Sasia	Vlera(EURO)	Çmimi mesatar	Përqindja
Shqipëria	172,000,801.00	71,197,332.02	0.41	82%
Bosnje dhe Herc.	21,138,650.00	8,968,395.81	0.42	10%
Serbia	5,736,980.00	2,356,372.94	0.41	3%
Turqia	3,547,668.00	1,344,439.54	0.38	2%
Italia	2,897,837.00	1,151,940.70	0.40	1%
Greqia	2,612,830.00	1,090,952.88	0.42	1%
Maqedonia	1,795,900.00	794,605.19	0.44	1%
AD	204,100.00	81,640.00	0.40	0%
DE	26,920.00	11,844.80	0.44	0%
CH	40,520.00	7,635.03	0.19	0%
CN	2,690.00	1,486.08	0.55	0%
Totali	210,004,896.00	87,006,644.99	0.41	100%

Grafiku nr.2 Importi i çelikut sipas shteteve, 2020




Çeliku në Kosovë importohet nga shumë shtete me çmime të ndryshme. Sa i përket vitit 2020 sipas të dhënave doganore, importi me vlerën më të madhe gjatë vitit 2020 ka ardhur nga Shqipëria me çmim mesatar 0.41 cent/kg. Për shkak të **specifikave të produktit** rreth 82% e importit të çelikut është bërë nga Shqipëria. Në vendin e dytë pason Bosnja dhe Hercegovina me 10% të tregut importues dhe me çmim mesatar rreth 0.42 cent/kg, e përcjellur nga Serbia dhe Turqia me 0.38-41cent/kg.

Tabela nr.3 Kompanitë importuese, 2020

Kompanitë importuese	Vlera	Sasia	Çmimi mesatar	Përqindja
/	18,566,814.70	45,348,600.00	0.41	22%
/	14,852,330.46	36,050,914.00	0.41	17%
/	14,267,185.67	33,971,330.00	0.42	16%
/	12,833,768.00	31,006,980.00	0.41	15%
/	9,650,190.34	22,914,830.00	0.42	11%
/	6,913,532.69	16,979,736.00	0.41	8%
/	3,329,899.16	7,909,200.00	0.42	4%
/	1,632,058.80	3,962,900.00	0.41	2%
/	1,504,239.32	3,707,920.00	0.41	2%
/	3,456,625.85	8,152,486.00	0.42	4%
TOTALI	87,006,644.99	210,004,896.00	0.41	100%

Grafiku nr.3 Kompanitë importuese, 2020




Gjatë vitit 2020, sasia totale e importuar e miellit ishte 87,006,644.99 kg, me çmimi mesatar prej 0.41cent/kg. Kompania me më së shumti sasi importi për këtë vit ishte _____ e cila mbulon 22% të këtij tregu. Duke pasuar nga kompania _____ me 17%, ndërsa kompanitë me më sa paku import janë _____ dhe _____ të cilat mbulojnë vetëm 2% të tregut të importit të çelikut në Kosovë.

4.2 Importi i çelikut për vitin 2021

Tabela nr.4 Importi i çelikut gjatë muajve, 2021

Muajt	Sasia	Vlera (EURO)	Çmimi mesatar
1	6,494,364.00	3,268,422.70	0.50
2	6,736,660.00	3,530,224.10	0.52
3	17,137,930.00	9,003,174.35	0.53
4	17,168,410.00	9,119,890.41	0.53
5	27,740,655.00	15,361,370.15	0.55
6	16,568,120.00	10,182,849.86	0.61
7	13,191,400.00	8,302,164.12	0.63
8	16,512,006.00	10,135,581.65	0.61
9	25,114,030.00	15,116,982.21	0.60
10	25,000,990.00	15,573,098.14	0.62
11	22,962,000.00	15,392,341.76	0.67
12	9,625,187.00	6,608,220.48	0.69
TOTALI:	204,251,752.00	121,594,319.93	0.60

Grafiku nr.4 Lëvizja e çmimit mesatar në vitin 2021




Gjatë vitit 2021 sasia totale e importuar krahasuar me vitin 2020 ishte pothuajse e njëjtë, por çmimi mesatar i importit ka pasur trende rritëse. Çmimi mesatar i importuar gjatë vitit 2021 ishte 0.60 cent, rreth 0.20 cent më e lartë se gjatë vitit 2020. Gjatë vitit 2021 çdo muaj ka pasur trende rritëse të çmimit, dhe në muajin e 12-të, çmimi mesatar importues i çelikut ka arritur në 0.69 cent.

Tabela nr.5 Importi i çelikut sipas shteteve, 2021

Shtetet importuese	Sasia	Vlera (EURO)	Çmimi mesatar	Përqindja
Shqipëria	181,072,490.00	107,104,121.44	0.59	89%
Bosnja dhe Hercegovina	10,146,470.00	6,489,105.66	0.64	5%
Serbia	7,348,845.00	4,720,127.35	0.64	4%
Greqia	3,262,360.00	1,977,539.20	0.61	2%
Italia	2,168,200.00	1,170,712.00	0.54	1%
Zvirra	170,250.00	81,496.83	0.48	0%
Maqedonia	79,220.00	46,737.20	0.59	0%
Gjermani	1,594.00	2,548.50	1.60	0%
CN	1,781.00	1,498.10	0.84	0%
Turqia	542.00	433.65	0.80	0%
TOTALI	204,251,752.00	121,594,319.93	0.60	1.00

Grafiku nr.5. Importi i çelikut sipas shteteve, 2021




Edhe në vitin 2021, sipas të dhënave doganore importi i produktit të çelikut është i fokusuar në shtetin e Shqipërisë, me rreth 89% të tregut importues, por në vitin 2021 çmimi importues është rritur në 0.59 cent/kg. Bosnja dhe Hercegovina është importuesi i dytë në Kosovë për produktin e çelikut me 5%, dhe me një çmim mesatar 0.64 cent/kg, e përcjellur nga Serbia dhe Greqia.

Tabela nr.6 Kompanitë importuese, 2021

Kompanitë importuese	Sasia	Vlera(EURO)	Çmimi mesatar	Përqindja
/	46,562,340.00	26,023,233.00	0.56	23%
/	27,350,280.00	16,919,139.24	0.62	13%
/	27,340,620.00	14,563,584.64	0.53	13%
/	20,589,990.00	12,958,392.35	0.63	10%
/	20,483,200.00	12,588,370.18	0.61	10%
/	16,479,520.00	10,444,330.33	0.63	8%
/	13,846,800.00	8,788,568.22	0.63	7%
/	9,074,890.00	5,445,948.08	0.60	4%
/	7,816,150.00	4,998,224.20	0.64	4%
/	4,579,610.00	2,636,924.10	0.58	2%
/	10,128,352.00	6,227,605.59	0.62	5%
TOTALI	204,251,752.00	121,594,319.93	0.60	100%

Grafiku nr. 6 Kompanitë importuese, 2021



Ashtu si në vitin 2020, në vendin e parë të kompanive të cilat importojnë çelik në Kosovë e mban kompania _____ me 23% import, përkatësisht me çmim mesatar rreth 0,56cent/kg. Kompania me më së paku import të çelikut në Kosovë qëndron Kompania _____ me 2% import të çelikut.


Sa i përket çmimit mesatar, ndër kompanitë importuese me çmim mesatar më të ulët e mban kompania _____ me 0,53 cent/kg.

4.3 Importi i çelikut për vitin 2022

Tabela nr.7 Importi i çelikut gjatë muajve, 2022

Muajt	Sasia	Vlera (EURO)	Çmimi mesatar
1	8,285,610.00	5,559,626.42	0.67
2	16,485,720.00	11,176,719.68	0.68
3	19,352,475.00	14,659,393.36	0.76
4	11,892,778.00	10,398,357.00	0.87
5	11,815,802.00	10,533,968.01	0.89
6	18,358,268.00	14,254,368.63	0.78
7	19,385,310.00	13,935,339.75	0.72
8	22,110,618.00	15,550,989.80	0.70
9	24,700,628.00	17,168,708.07	0.70
10	19,536,853.00	13,995,838.31	0.72
11	21,362,135.00	14,686,835.05	0.69
12	14,441,788.00	9,504,673.74	0.66
TOTALI:	207,727,985.00	151,424,817.82	0.73

Grafiku nr.7 Lëvizja e çmimit mesatar në vitin 2022




Në muajt e parë të vitit 2022 vërehet një rritje e çmimit mesatar importues nëpër muaj, me theks të veçantë në muajin Prill 2022, kur çmimi mesatar importues arriti në 0.87 cent/kg, kurse në muajin Maj 2022 arriti në 0.89 cent/kg. Muaji Maj ishte muaji kur çmimi mesatar importues ishte më i larti gjatë viteve të fundit. Në muajin e 3-të të vitit 2022 kemi një sasi mjaftë të lartë

importuese, kurse me rritjen e çmimit mesatar, sasia e importuar bie në 11 milion kg. Çmimi mesatar importues për vitin 2022 ishte 0.73 cent/kg, rreth 30 cent/kg më i lartë se në vitin 2022.

Tabela nr.8 Importi i çelikut sipas shteteve, 2022

Shtetet importuese	Sasia	Vlera(EURO)	Çmimi mesatar	Përqindja
Shqipëria	149,671,227.00	111,028,031.54	0.74	72%
Bosnje dhe Hercegovina	18,397,680.00	13,373,688.90	0.73	9%
Turqia	17,355,530.00	11,444,861.22	0.66	8%
Serbia	12,095,130.00	8,376,906.48	0.69	6%
Greqia	4,420,500.00	3,136,098.03	0.71	2%
Zvicra	2,707,660.00	1,814,336.01	0.67	1%
Italia	2,234,060.00	1,633,165.60	0.73	1%
Maqedonia	795,248.00	579,681.37	0.73	0%
Gjermani	26,120.00	19,222.77	0.74	0%
Bullgaria	24,830.00	18,825.90	0.76	0%
TOTALI	207,727,985.00	151,424,817.82	0.73	100%

Grafiku nr.8. Importi i çelikut sipas shteteve, 2022




Gjatë vitit 2022, importi i produktit të çelikut vazhdon me ritme më të ngadalta në sasinë e importuar, për shkak të çmimit mesatar të lartë për import. Edhe në vitin 2022 është vazhduar importi në masë të madhe nga Shqipëria, me 72%, e përcjellur nga Bosnja dhe Hercegovina me 9%, Turqia me 8% dhe Serbia me 6%. Gjatë këtij viti çmim më i ulët mesatar kushtues ishte nga Turqia, por bazuar në distancën transportuese, importi ishte i fokusuar në masë të madhe në shtetin e Shqipërisë.

Tabela nr.9 Kompanitë importuese të çelikut, 2022

Kompanitë importuese	Sasia	Vlera(EURO)	Çmimi mesatar	Përqindja
/	45,348,560.00	33,404,948.26	0.74	22%
/	22,960,489.00	16,352,398.08	0.71	11%
/	21,469,890.00	16,185,977.38	0.75	10%
/	20,294,960.00	15,552,903.88	0.77	10%
/	20,510,630.00	15,101,503.25	0.74	10%
/	21,013,999.00	14,213,217.73	0.68	10%
/	17,932,680.00	13,333,347.09	0.74	9%
/	13,129,740.00	9,887,946.46	0.75	6%
/	10,801,420.00	7,455,989.62	0.69	5%
/	6,565,959.00	4,524,123.30	0.69	3%
/	7,699,658.00	5,412,462.77	0.70	4%
Totali	207,727,985.00	151,424,817.82	0.73	100%

Grafiku nr.9 Kompanitë importuese, 2022



Kompania _____, vazhdon të jetë kompania e cila importon më së shumti sasi të çelikut në Kosovë, këtë vit ka importuar gjithsej 45,348,560.00 kg, përkatësisht 22% mbulueshmëri të këtij tregu. Duke u pasuar nga kompania tjetër _____, e cila mbulon 11% të tregut të çelikut për Kosovë.


Kompania me më së paku sasi importi të çelikut në Kosovë, edhe për këtë vit vazhdon të jetë kompania _____ me sasi importi prej 6,565,959.00 kg, përkatësisht 3% të këtij tregu.

4.4 Importi i çelikut për vitin 2023

Tabela nr.10 Importi i çelikut gjatë muajve, 2023

Muajt	Sasia	Vlera (EURO)	Çmimi mesatar
2	14,494,057.00	9,679,624.33	0.67
3	24,187,110.00	16,160,927.77	0.67
4	12,046,969.00	8,056,515.73	0.67
5	19,924,253.00	12,711,535.10	0.64
6	19,555,635.00	11,680,968.21	0.60
7	17,191,010.00	9,981,333.76	0.58
8	25,694,432.00	14,579,998.24	0.57
9	28,014,072.00	16,006,192.02	0.57
10	23,020,706.00	13,219,586.17	0.57
11	25,121,872.00	14,492,545.12	0.58
12	15,841,663.00	9,314,542.49	0.59
TOTALI:	239,243,385.00	145,325,926.37	0.61

Grafiku nr.10 Lëvizja e çmimit mesatar në vitin 2023




Gjatë vitit 2023 sipas të dhënave zyrtare vërehet një çmim mesatar importues në rënje për produktin e çelikut, muaj pas muaji. Siç mund të vërehet përmes tabelës, në muajt e fundit të vitit 2023 kemi rënie mjaft domethënëse të çmimit krahasuar me vitin paraprak. Çmimet më të lira të importit kanë ndikuar në sasinë më të madhe të importuar gjatë katër viteve të fundit. Sasia më e lartë e importuar vërehet me rënien e ndjeshme të çmimit krahasuar me muajt në fillimin e vitit 2023.

Tabela nr.11. Importi i çelikut sipas shteteve ,2023

Shtetet importuese	Sasia	Vlera(EURO)	Çmimi mesatar	Përqindja
Shqipëri	196,762,130.00	119,343,865.51	0.61	82%
Turqi	24,392,263.00	14,423,276.88	0.59	10%
BA	7,372,590.00	4,758,886.02	0.65	3%
Greqi	4,004,730.00	2,630,576.43	0.66	2%
Itali	2,527,900.00	1,583,974.37	0.63	1%
Maqedonia	2,524,462.00	1,516,712.41	0.60	1%
Serbia	1,656,890.00	1,065,670.87	0.64	1%
Të tjera	2,420.00	2,963.88	1.22	0%
TOTALI	239,243,385.00	145,325,926.37	0.61	100%

Grafiku nr.11 Importi i çelikut sipas shteteve, 2023




Sipas të dhënave doganore, gjatë vitit 2023, kemi shënuar rritjen më të lartë të sasisë importuese të produktit të çelikut. Është importuar rreth 82% nga Shqipëria, 10% nga Turqia dhe e përcjellur nga Bosnja me 3%. Çmimi mesatar importues ka pësuar rënie krahasuar me vitin paraprak, prandaj kemi edhe rritje të sasisë gjatë këtij viti. Çmimi importues nga Shqipëria ishte 0.61 cent/kg, kurse nga Turqia 0.59 cent/kg. Parashikimet flasin për një çmim importues pa lëvizje shqetësuese gjatë këtij viti.

Tabela nr.12 Kompanitë importuese të çelikut, 2023

Kompanitë importuese	Sasia	Vlera(EURO)	Çmimi mesatar	Përqindja
/	54,030,200.00	32,554,321.29	0.60	23%
/	35,829,930.00	21,277,400.52	0.59	15%
/	29,487,740.00	17,891,649.91	0.61	12%
/	26,106,760.00	15,744,161.19	0.60	11%
/	23,265,460.00	14,334,057.36	0.62	10%
/	21,189,170.00	13,284,970.10	0.63	9%
/	21,399,200.00	12,971,491.80	0.61	9%
/	16,296,810.00	9,917,376.84	0.61	7%
/	4,008,660.00	2,419,924.90	0.60	2%
/	3,575,240.00	2,308,923.35	0.65	1%
/	4,054,215.00	2,621,649.11	0.65	2%
TOTALI	239,243,385.00	145,325,926.37	0.61	100%

Grafiku nr.12 Kompanitë importuese, 2023




_____, vazhdon të qëndron e para në importin e çelikut në Kosovë. Në vitin 2023 sasia e importuar e çelikut ka arritur deri në 54,030,200.00kg me çmim mesatar prej 0.60cent/kg, kryesisht 23% mbulueshmëri të këtij tregu.

Ndërsa kompania me më së paku sasi importi, qëndron kompania _____ me vetëm 1% të tregut të çelikut.

5. Shkalla e përqendrimit të tregut të importit tek çeliku

Figura 2. Nivelet e referencës së përqendrimit - të matura nga Indeksi Herfindahl-Hirschman



Sipas Indeksit Hefindahl Hirschman konstatojmë se në tregun e importit të çelikut, si produkt i përpunuar, në vitin 2020 vërehet një shkallë e moderuar e koncentrimit, ku niveli i indeksit është 1479. Ky nivel në bazë të niveleve të referencës së përqendrimit (0-10000) tregon se niveli i konkurrencës është i moderuar. Sa i përket vitit 2021, niveli i indeksit rezultoi të jetë 1241. Edhe në këtë vit kemi një treg të moderuar me konkurrencë të hapur.

Sipas Indeksit Hefindahl Hirschman konstatojmë se në tregun e importit të çelikut, në vitin 2022 vërehet një shkallë e lartë e koncentrimit, ku niveli i indeksit është 1172. Ky nivel në bazë të niveleve të referencës së përqendrimit (0-10000) tregon se niveli i konkurrencës është i moderuar. Kurse sa i përket vitit 2023, niveli i indeksit rezultoi të jetë 1172. Ku ky nivel në bazë të niveleve të referencës së përqendrimit (0-10000) tregon se ekziston një treg i moderuar i përqendrimit.

5.1 Transparenca e tregut të çelikut

Ashtu si në sektorë të tjerë, tendencat e fundit inflacioniste, për shembull, në koston e materialeve të ndërtimit dhe punës, kanë vënë presion mbi zinxhirin e furnizimit.

Sipas praktikave të vendeve të BE-së por edhe të rajonit, ekziston një konsensus për tregun e çelikut, se është e nevojshme rritja e transparencës, duke mbledhur dhe vënë në dispozicion më shumë informacion mbi sektorin e çelikut, në veçanti transmetimin e çmimeve për pjesën e poshtme të zinxhirit të furnizimit.

Transparenca e tregut është një element kyç për sektorin e ndërtimit pasi përmirëson fuqinë negociuese të ndërmarrjeve gjatë negociatave për kontratat duke krijuar një fushë loje më të barabartë. Përveç kësaj, transparenca e tregut ndihmon në ndërtimin e besimit midis aktorëve të

tregut. Një iniciativë e mundshme, për Transparencën e Tregut mund të synoj një adresim korrekt të kësaj çështje.

Sipas këndvështrimit të praktikave në BE, shkallë transparence duhet të zbatohet për fazën e përpunimit dytësor dhe shitësit me pakicë, në mënyrë që të sigurohet që ndërmarrjet të kenë qasje në produktet e përpunuara me një çmim të drejtë dhe të përmirësojnë ekuilibrin përgjatë zinxhirit të furnizimit.

Çmimet e tregut të prodhimit vendor, çmimet e importit, njëkohësisht edhe monitorimi i importeve, eksporteve, vëllimit dhe shitjeve, do të jetë thelbësor për të kuptuar nxitësit e tregut dhe analizuar tendencat e çmimeve të çelikut.

5.2 Situata aktuale në ndërmarrjet Kosovare

Autoriteti i konkurrencës ka përgatitur pyetësor lidhur me specifikat kryesore të produktit të çelikut dhe ka marrë përgjigjet nga kompanitë që merren me importin dhe shitjen e produktit të çelikut.

Të gjitha kompanitë importuese raportojnë sfida të shumtë nëpër të cilat kanë kaluar, si nga pandemia ashtu edhe nga lufta në Ukrainë. Mungesa e transportit, ndërprerjet në zinxhirin e furnizimit kanë shkaktuar regres në përmirësimin e operimit të ndërmarrjeve. Po ashtu, është vlerësuar nivel i lartë i konkurrencës në treg. Konkurrenca përfshin furnitorë rajonalë dhe globalë, dhe ka ndikuar në çmime dhe oferta të produkteve.

Disa prej kompanive, shprehin shqetësime lidhur me konkurrencën e pandershme dhe probleme me politikat fiskale që favorizojnë importuesit nga vendet tjera.

Forca ekonomike dhe financiare e kompanive ndryshon. Në përgjithësi, raporti tregon një treg të luhatur dhe të ndikuar nga faktorë të ndryshëm globalë dhe lokalë, me ndikime të ndryshme për secilën kompani. Analiza e tregut dhe çmimeve tregon sfida të rëndësishme dhe mundësi për zhvillim të mëtejshëm në sektorin e çelikut në Kosovë.

6.Konkluzionet për tregun e Çelikut

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës mblodhi informacion të gjerë dhe të detajuar nga burime të disponueshme publikisht, të dhëna dhe shpjegime të pjesëmarrësve të tregut dhe kërkime dhe të dhëna të disponueshme.

Autoriteti ka vlerësuar nëse ka pengesa të mundshme për hyrjen/zgjerimin ose ndonjë faktorë tjetër që mund të shtrembëroj konkurrencën.

Synimi i këtij studimi është zbulimi nëse ky treg specifik, apo elemente brenda tij, po funksionojnë mirë nga perspektiva e konkurrencës. Nëse nuk funksionon mirë, Autoriteti mund të shikojë mënyra të ndryshme për të adresuar problemet e identifikuara në studimin e tregut. Për shembull, mund të lëshojë udhëzime për bizneset, të ofrojë informacion ose udhëzime për konsumatorët dhe/ose të bëjë rekomandime për qeverinë ose autoritetet e tjera rregullatorë. Po ashtu, autoriteti mund të hapë një hetim, nëse identifikon prova se Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës mund të jetë shkelur dhe se janë të nevojshme masat. Nga ana tjetër, në varësi të informacionit të mbledhur, një studim tregu mund të zbulojë njësoj se nuk lindin shqetësime për konkurrencën në një treg të caktuar.

Rëndësia e sektorit të ndërtimit për ekonominë kosovare dhe ndërlidhja e aktivitetit të ndërtimit me sektorë tjerë industrialë dhe tregtarë përbën një faktor kyç për nisjen e një ndërhyrjeje në industrinë e ndërtimit.

Kjo industri është përballur me një mjedis të pafavorshëm viteve të fundit, bazuar në çmimet e larta dhe kërkesën në ulje viteve të fundit. Shfaqja e Covid – 19 e vuri gjithashtu ekonominë në një tkurrje të fortë, e cila megjithatë pritet të tregoj rritje të fortë në vitet e ardhshme.

Konkurrenca në industrinë e çelikut u konstatua kryesisht ndërmjet kompanive me kapacitet të barabartë ose të ngjashëm. Konkurrenca në sektor rezultoi e fokusuar në nivelin e çmimeve, pasi ndërmarrja ose jo e një projekti lidhet kryesisht me çmimet e ofertës. Gjatë përcaktimit të nivelit të çmimit, ata nuk mund të injorojnë reagimet e mundshme të konkurrentëve, dhe struktura të tilla të tregut janë veçanërisht të favorshme për krijimin e qartë ose jo të marrëveshjeve të hesitura horizontale ndërmjet pjesëmarrësve të tregut. Sot, sektori i çelikut në Kosovë është një industri moderne e orientuar drejt klientit. Rrjedhimisht, pozicioni konkurrues është i lidhur fort me inovacionin e produktit dhe krijimin e vlerës, të mbështetur nga teknologjia e avancuar dhe zhvillimi teknologjik.

Politikat e shitjes së prodhuesve dhe importuesve të çelikut janë komplekse, të pamjaftueshme të qarta dhe transparente për klientët ekzistues. Kompanitë importuese të çelikut u japin klientëve të tyre lloje dhe forma të ndryshme zbritjesh, të cilat janë subjekt i ndryshimeve të shpeshta. Mungesa e një politike tregtare të qartë dhe transparente lë mundësinë që zbritjet të aplikohen në mënyrë selektive, gjë që mund të vendosë pjesëmarrësit individualë të tregut(klientët) në disavantazh krahasuar me konkurrentët dhe në këtë mënyrë të kufizojë potencialisht konkurrencën.

Çmimi i shitjes së çelikut diktohet nga kostoja e importit bazë, e cila përbën ndërmjet 60% dhe 80% të çmimit të shitjes.

Importi i çelikut në Republikën e Kosovës ka trend rritës.

6.1 Rekomandime

- Rekomandohet që Autoriteti të kryejë fillimisht kërkime paraprake të tregut për të përcaktuar strukturat e tregut në proceset kryesore të ndërtimit dhe më pas të vendosë nëse duhet të kryhet një studim zyrtar i thelluar i tregut në disa segmente specifike (më të ngushta) të sektorit të ndërtimit.
- Importuesit e çelikut rekomandohen t'i bëjnë politikat e tyre tregtare sa më të sakta dhe të qarta për klientët ekzistues dhe potencial. Ekzistenca e politikave komplekse, të pamjaftueshme të qarta dhe transparente të shitjes i lë mundësinë pjesëmarrësve të tregut që të negociojnë zbritjet dhe zbritjet e tjera në kontakt të drejtpërdrejtë me blerësin, në të cilin rast çmimi përfundimtar mund të ndikohet nga fuqia negociuese e blerësit. Duke aplikuar në mënyrë selektive politikën e zbritjes, pjesëmarrës të caktuar të tregut(klientë) mund të vihen në një pozitë të pafavorshme në krahasim me konkurrentët, gjë që potencialisht kufizon konkurrencën në treg.
- Kalimi në politika tregtare më të sakta dhe më të qarta, të bazuara në sasi dhe/ose në vendndodhje, pavarësisht nga identiteti i klientit apo projekti specifik, mund të nxisë konkurrencën edhe më shumë, gjë që do të ndikonte më tej pozitivisht në të gjitha segmentet e aktivitetit të ndërtimit.
- Rekomandohet Qeveria e Kosovës që të krijoj një strategji afatgjatë për zhvillimin e tregut të çelikut duke përcjellur zingjirin e furnizimit në tregun botëror, lehtësimin e importit dhe zbutjen e ndikimeve nga krizat globale.

- Ministria e Industrisë, Ndërmarrsisë dhe Tregtisë duhet të ndërmarrë hapa për të krijuar marrëveshje dypalëshe me vende prodhuese të mëdha të celikut, si Turqia, Italia dhe vende tjera të rajonit.
- Të promovohet bashkëpunimi me CEFTA për të ulur tarifatat doganore për celikun dhe për të krijuar lehtësira të tjera tregtare.
- Të ofrojnë stimuj fiskalë për kompanitë ndërkombëtare të celikut që duan të investojnë në ndërtimin e kapaciteteve prodhuese në Kosovë.
- Të krijohet një mekanizëm për regjistrimin dhe publikimin e rregullt të çmimeve të celikut dhe volumit të tregtisë, për të rritur transparencën dhe për të ndihmuar në monitorimin e tregut.

Rekomandohet që pjesëmarrësit e tregut të shmangin sjelljet që mund të ndikojnë në marrjen e pavarur të vendimeve të biznesit të pjesëmarrësve të tjerë të tregut, veçanërisht veprimet që mund të çojnë në shkëmbimin e të dhënave dhe informacionit të biznesit me pjesëmarrësit e tjerë të tregut drejtpërdrejt dhe/ose indirekt përmes shoqatave. Tregjet e karakterizuara nga strukturat klasike oligopoliste të tregut janë veçanërisht të përshtatshme për koordinimin e sjelljes midis konkurrentëve, prandaj është e rëndësishme që pjesëmarrësit në këto tregje të kujdesen që të mos shkëmbejnë informacione të ndjeshme komerciale, të mos dërgojnë sinjale të konkurrentët për ndryshimet e çmimeve dhe të mos operojnë në një mënyrë që mund të krijonte marrëveshje të fshehtë tregu.

Pas shqyrtimit paraprak në tregun relevant të çelikut, grupi punues propozon Komisionit të AKRK që ndaj subjekteve të cilat kanë ndikim të ndjeshëm mbi konkurrencën në tregun përkatës të vazhdohet me monitorimin e afërt të çmimeve, sasisë së importuar të çelikut.